L I G J
Nr.7735, datë 20.7.1993

PËR TAKSAT E ANIJEVE TË HUAJA QË PREKIN PORTET DETARE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Anijet e huaja që ngarkojnë ujë për eksport në pikat jashtë porteve paguajnë taksa portuale dhe taksa për formalitetet që kryen dogana e autoritetet e tjera në masën 300 dollarë amerikanë për çdo rast furnizimi.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.608, datë 29.7.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.